

## **PERMBLEDHJE JO TEKNIKE TE RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS.**

Subjekti " BELBA b & B " sh.p.k. me administrator z. Ditver Çela i regjistruar si person Juridik prane Q.K.B - se me date 25.09.2008 dhe me numer NIPT-i K88325601F ka hartuar Raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis te siperfaqes minerare per vendburimin " Gobile", fshati Stroske, Njesia administrative Qukes, Rrethi Librazhd ne kuoten +1325 m deri ne +1498m mbi nivelin e detit . Ky raport eshte pergatitur ne zbatim te ligjit Nr.10440 dt.07.07.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis " dhe Vendimit te keshillit te Ministrave Nr.419 dt. 25.06.2014 " Per miratimin e kerkesave te posaçme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipeve A,B dhe C, per transferimin e lejeve nga nje subjekt ne tjetrin, te kushteve per lejet respektive te mjedisit, si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKB - ja ".

**Qellimi dhe karakteristikat fizike te projektit , detaje te aksesit dhe transportit, si dhe numri i njerezve qe do te punesohen dhe nga do te vijne ata.**

Ky studim ka per qellim qe te planifikoje dhe drejtoje konform rregullave e kushteve tekniko ekonomike , shfrytezimin e rezervave gjeologjike te mineralit te kromit ne objektin " Gobile ", fshati Stroske, Njesia administrative Qukes, Rrethi Librazhd . Shfrytezimi i mineralit te kromit do te behet ne nentoke me ane te punimeve te shpim plasjes ne miniere . Projekti ne fjale ka nje siperfaqe prej 0.3 km<sup>2</sup> e cila ndodhet ne fshatin Stroske,Librazhd .Si rezultat i shfrytezimit te rezervave gjeologjike te mineralit te kromit jane parrashikuar te nxiren rreth 6800ton mineral krom me cilesi 38 % Cr<sub>2</sub>O.

Persa i perket rrjetit te transportit, ky rrjet eshte i ndertuar dhe eshte mirembajtur vazhdimisht .

Per shfrytezimin e ketij objekti subjekti ka parashikuar te punesoje rreth 22 punonjes perfshire dhe stafin teknik .

## **1.2. Kerkesat e perdorimit te tokes dhe karakteristike te tjera fizike te projektit**

Projekti do te zbatohet ne objektin “ Gobile “, fshati Stroske, Rrethi Librazhd . Ne kete objekt do te behet vetem shfrytezimi i mineralit te kromit . Sheshi i depozitimit te sterilizimit dhe te mineralit do te jete brenda fushes minerare ne siperfaqe.

Nga aktiviteti i shfrytezimit te mineralit ne kete objekt nuk kemi te bejme me perdorim te tokes , si persa i perket periudhes se hapjes , shfrytezimit apo mbas tyre . Kjo per shkak se aktiviteti minerar do te zhvillohet ne nentoke.

## **1.3 Proçesi i prodhimit dhe karakteristikat e tij .**

Aktiviteti te cilin do te ushtroje subjekti eshte bazuar ne Ligjin Minerar Shqiptar dhe konsiston ne shfrytezimin e mineralit te kromit . Per te shfrytezuar keto rezerva , nga subjekti do te hapen punime te cilat do te kalojne neper trupin minerar. Produkt i ketyre punimeve eshte minerali i kromit dhe si i tille do te depozitohet ne sheshin e depozitimit te mineralit dhe do te transportohet me mjetet e transportit per ne destinacion sipas kerkesave te tregut .

## **1 Pershkrimi i vendit dhe mjedisit te tij .**

Vendi ku kerkohet te ushtrohet aktiviteti i nxjerrjes se mineralit te kromit , pra objekti “ Gobile “, fshati Stroske, Njesia administrative Qukes, Rrethi Librazhd, eshte nje zone brenda fushes minerare te lejes se shfrytezimi, jo shume larg qytetit te Prenjasit . Keshtu qe fuqia punetore do te merret kryesisht nga Prenjasi dhe nga fshatrat perreth . Klima e zones eshte kontinentale , me vere te nxehte e te thate e dimer te ftohte. Objekti eshte i lidhur me rrugen nacionale Prenjas – Librazhd - Elbasan , e cila aktualisht eshte e punueshme , ne te kalojne mjetet qe transportojne punetoret e mineralin e kromit . Aktiviteti do te zhvillohet ne brendesi te minieres dhe per rjedhoje ky aktivitet nuk do te ndikojte absolutisht ne floren dhe faunen e

siperfaqes edhe pse keto nuk jane te mbrojtura me status te veçante apo te bejne pjese ne lloje dhe specie te varieteteve te veçanta .

Ujrat nentokesore, qe permbajne trupat xeherore dhe shkembinjte rrethues , jane te çarjeve dhe si rrjedhim kane nje shperndarje jo te njetrajshe . Prurjet e ujit qe ushqehen nga ujrat siperfaqesore jane ne varesi te thellesise se punimeve dhe jane me te medha ne kohe me rreshje dhe gjate shkrirjes se debores . Por eshte e sigurte qe ujrat nentokesore te cilat shtohen gjate rreshjeve dhe shkrirjes se debores do te dalin ne siperfaqe nga punimet e kryera me poshte , dhe ne keto galeri nuk pritet te kete ujra dhe probleme gjate shfrytezimit te mineralit te kromit .

Kjo zone nuk perben rendesi te trashegimise arkitektonike sepse ne kete zone nuk ka asne lloj ndertimi te kohes se sotme apo te kohes se kaluar . Rendesia e kesaj zone , qendron ne potencioalin e madh qe ka nentoka , persa i takon mineralit te kromit dhe te hekurit .

Nga pikpamja e rilievit , vendi ku eshte hapur miniera i perket nje zone malore e ç'veshur nga bimesia e larte .

Gjate shfrytezimit te objektit parashikohet rigjenerimi hap pas hapi i zones se shfrytezimit , me kryerjen e punimeve suplementare te mbushjes dhe sistemimit .

Kjo zone nuk ben pjese ne zonat e caktuara me ligj si rezervate kombetare , zone me interes shkencor te veçante , park kombetar , zone me bukuri te rralla natyrore, brigjet e trasheguara , parqet rajonale dhe rurale, parqet pyjore kombetare, rezervat lokale natyrore , zonat ujore te mbrojtura , monumentet e lashtesise , si dhe zonat me rendesi arkeologjike .

Ne zonen ku do te ushtrohet aktiviteti i shfrytezimit te mineralit te kromit , nuk ka zogj te eger te cilet duhet te mbrohen sipas direktivave te BE per “ Zogjte e Eger “. Gjithashtu zona eshte larg qendrave te banuara dhe nuk perfaqeson ndonje zone , e cila te trajtohet konform Konventes Boterore Kulturore apo Konventes se Ramsarit .

### **3. Vleresimi i ndikimeve .**

Zbatimi i projektit nuk do te ndikojte ne popullsi per vete faktin se ai do te zbatohet larg qendrave te banuara . Si ndikim permendim punesimin e nje numri

punonjesish dhe hapjen e perspektives per ritjen e numrit te punonjesve te punesuar .

Nga zbatimi i projektit nuk do te kete ndryshim te pejsazhit .

Per sa i perket niveleve te ndikimeve e emetimeve te ardhura nga projekti verejme se ato jane zero , sepse ky projekt konsiston ne marrjen e mineralit ne nje miniere te hapur me pare. Operacionet do te kryhen ne siperfaqe dhe nentoke te cilat nuk emetojne elemente te demshem per mjedisin .

Persa i perket nivelit te zhurmave gjate operacioneve te punes ,siç eshte shpimi i birave, kemi te bejme me nivele qe i kalojne normat e lejuara. Ne menyra qe te eliminohet ndikimi i tyre , punonjesit do te paisen me kufje per tu mbrojtur nga zhurmat .

Projekti i shfrytezimit do te zbatohet ne nentoke , ne nje zone ku as ne siperfaqe te saj dhe as ne nentoke nuk ka ndertime te trashegimise arkitektonike dhe historike , tiparet arkeologjike , si dhe vepra te tjera njerezore .

Ne zonen e objektit ne pergjithesi eshte e xhveshur nga bimesia me perjashtim te barishteve dhe shkureve te ulta . Ne siperfaqe nuk ka pyje dhe drure te larte . Po ashtu dhe fauna karakteristike e zones eshte e paprekshme nga efektet e shfrytezimit .

Gjate dhe pas shfrytezimit nuk do te kete ndryshime ne topografine lokale . ne kete projekt eshte parashikuar nje rradhe dhe drejtim i tille shfrytezimi , qe ne kombinim me masat e tjera suplementare te mbushjes , sistemimit dhe trajtimit , parandalojne erozionin , shembjen dhe vithisjen e siperfaqes se tokres perreth saj .

Aktiviteti parashikon vetem shfrytezimin e mineralit te kromit dhe nuk leshon elemente kimike ose te tjere te demshem per mjedisin .

Siperfaqja qe do ti nenshtrohet shfrytezimit nuk eshte toke bujqesore . ushtrimi i aktivitetit nuk ndikon negativisht ne cilesine dhe sasine e tokes bujqesore .

Ne zonen e shfrytezimit hap pas hapi dhe ne perfundim te aktivitetit eshte parashikuar sistemimi, perpunimi, shtrimi dhe ndertimi i nje sere murresh mbajttese ne stogjet e sterileve te trasheguara .

Gjate ushtrimit te aktivitetit, subjekti do te kryeje çdo vit sistemime dhe rregullime perr rreth objektit .

Siperfaqja qe do ti nenshtrohet shfrytezimit, pas perpunimit, trajtimit, sistemimit dhe mbulimit te pjesshem te saj , do te kthehet ne nje siperfaqe te mbjelle kryesisht me pisha , barishte e shkure dhe peme karakteristike te zones .

#### **4. Masat zbutese**

Per shmangien dhe parandalimin e erozionit, shembjes se siperfaqes dhe vithisjeve te ndryshme, ne projekt eshte parashikuar shfrytezimi harmonik dhe i kombinuar ne kohe dhe hapësire i zones ne teresi . Gjithashtu subjekti çdo vit do te kryeje punime te ndryshme sistemimi te sterileve te depozituara ne stogjet ekzistuese .

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem, te parashikuar ne projekt do te varen nga respektimi i te gjithe treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permiresimi i vazhdueshem, sipas kushteve te shfrytezimit do te çoje perfundimisht ne perfitimin e pamjeve te parashikuara ne projekt me siperfaqe te sistemuara dhe te gjelberuara .

Pergatiti permbledhjen **Ing . Remzi PUPLI**



Liçencuar nga Ministria e Mjedisit Nr.427 dt . 01.08.2007